

## Teuta/ Largohet nga drejtimi Gugash Magani

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 16 Nentor 2013 20:05

---



Dy humbjet e fundit kane sjelle largimin e Gugash Maganit na pankina e Teutes. Nje lajm te tille e ka konfirmuar vete presidenti i durrsakeve Edmond Hasanebelliu. “Me Maganin jemi ndare si miq. Ai beri nje pune te mire por ne tani kemi nje projekt tjeter dhe synojme te bejme nje skuader europiane”, ka deklaruar Hasanbelliu. Magani eshte pershendetur me skuadren dhe eshte larguar pas nje aventure jo te gjate ne stolin e “Djemve te Detit” te cilit i ngjiti ne vendin e dyte si nje nga dy pretendentet per titull bashke me skuadren e Skenderbeut.